



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Nr. 623 Prot.

Tiranë, më 02.02.2026

NJOFTIM

**PËR HAPJEN E GARËS PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR ANËTAR
(GJYQTAR) NË KËSHILLIN DREJTUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në zbatim të nenit 247, shkronja “d” të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, sipas të cilit Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve zgjedh një gjyqtar me përvojë si anëtar të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, me qëllim garantimin e një procesi transparent, të barabartë dhe të verifikueshëm, shpallet e hapur gara për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarit gjyqtar në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

I. Arsyeja e hapjes së garës

Sipas nenit 247 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, në përbërje të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës është dhe 1 (një) gjyqtar me përvojë, që caktohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, me një mandat 4 (katër) vjeçar.

Me anë të vendimit nr. 2, datë 08.10.2021 të Komisionit të Votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve është zgjedhur anëtari i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mandati i të cilit ka përfunduar me datë 08.10.2025.

Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2025, ka vënë në dijeni Kryetarin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, për përfundimin e mandatit të anëtarit, si dhe për nevojën e nisjes së procedurës për zgjedhjen e anëtarit të ri nga radhët e gjyqtarëve.

Në këto kushte, lind detyrimi ligjor për shpalljen e thirrjes me qëllim kandidimin e gjyqtarëve të interesuar për të plotësuar vendin vakant të krijuar në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

II. Kushtet që duhen plotësuar për kandidimin

Çdo gjyqtar, që do të kandidojë duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Të jetë gjyqtar me përvojë;
2. Të mos jetë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
3. Të shprehë gatishmëri për të kontribuar si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit.

III. Dokumentacioni i nevojshëm për kandidimin

Kandidatët duhet të paraqesin:

1. Kërkesë për kandidim, me të dhënat e kontaktit;
2. Curriculum Vitae të përditësuar;
3. Deklaratë personale mbi papajtueshmërinë (që kandidati nuk është anëtar i KLGJ-së dhe nuk ndodhet në kushte të tjera papajtueshmërie);
4. Platformë e shkurtër (1–2 faqe) ku pasqyrohen:
 - përvoja profesionale relevante;
 - kontributi i pritshëm në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës;
 - vizioni për forcimin e lidhjes ndërmjet gjyqësorit dhe Shkollës së Magjistraturës si dhe përmirësimin e formimit profesional;
 - çdo dokument tjetër mbështetës që kandidati e vlerëson të nevojshëm (p.sh. angazhime trajnuese, botime, pjesëmarrje në aktivitete të Shkollës së Magjistraturës, etj.).

IV. Afati i aplikimit

Afati i fundit për paraqitjen e kandidaturave është 20.02.2026.

V. Mënyra e paraqitjes së aplikimit

Kërkesa së bashku me dokumentacionin dorëzohet në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

1. *dorazi*, pranë zyrës së protokollit të institucionit të Gjykatës së Lartë (nga ora 08:00-16:00);
2. *me postë*, në adresën postare zyrtare të Gjykatës së Lartë: Gjykata e Lartë, Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 20, 1001, Tiranë;
3. *me postë elektronike*, në adresën zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë: info@gjykataelarte.gov.al, me subjekt "*Kandidim – Anëtar (gjyqtar) në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës*". Dokumentacioni duhet të jenë në format PDF.

VI. Procesi i verifikimit dhe zgjedhjes

Pas përfundimit të afatit të aplikimit do të njoftohet lista e kandidatëve, si dhe do të kryhet verifikimi formal i dokumentacionit të paraqitur.

Kryetari i Këshillit Drejtues thërret Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Për të gjithë procedurën e kandidimit, votimit dhe zgjedhjes së kandidatëve, gjejnë zbatim dispozitat dhe standardet procedurale të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 për Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve në proceset zgjedhore, me synim respektimin e parimeve të transparencës, barazisë së mundësive dhe integritetit të procesit.

KRYETARI
SOKOL SADUSHI

